

# Forcimi i mbështetjes financiare për bizneset në pronësi të grave dhe pakicave etnike në Kosovë

*Pasqyrë e granteve dhe subvencioneve  
të ofruara nga institucionet e nivelit  
qendror, nivelit lokal dhe  
organizatave jo-qeveritare*



## Imprint

### Botuesi

Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra në Prishtinë  
Rr. Pashko Vasa Nr. 23  
10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës

### Përgjegjësia për përmbajtjen dhe redaktimin

Katharina Hofmann

### Kontakti

Rudina Nallbani  
rudina.nallbani@fes.de

### Dizajni/Faqosja

Trembelat

### Shtypja dhe prodhimi

Studio Forma

Ky dokument është shkruar nga GAP. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk janë domosdoshmërisht ato të Friedrich-Ebert-Stiftung e.V. (FES). Përdorimi komercial i mediave të publikuara nga FES nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES. Publikimet e FES nuk mund të përdoren për qëllime fushate zgjedhore.

Gusht 2025

© Friedrich-Ebert-Stiftung e.V.

Publikime të mëtejshme të Friedrich-Ebert-Stiftung mund të gjenden:

➤ [www.fes.de/publikationen](http://www.fes.de/publikationen)

# **Forcimi i mbështetjes financiare për bizneset në pronësi të grave dhe pakicave etnike në Kosovës**

*Pasqyrë e granteve dhe subvencioneve të ofruara nga  
institucionet e nivelit qendror, nivelit lokal dhe  
organizatave jo-qeveritare*

# Tabela e përmbajtjes

|                                                                                                         |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje ekzekutive .....                                                                            | 4  |
| Hyrje .....                                                                                             | 5  |
| Metodologjia .....                                                                                      | 6  |
| Mbështetja financiare nga niveli qendror dhe insitucionet e pavarura .....                              | 7  |
| Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) .....                                                        | 7  |
| Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) .....                                   | 8  |
| Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) .....                                         | 10 |
| Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) .....                                                             | 11 |
| Të dhënat e anketës së GAP për përfituesit e granteve/subvencioneve nga niveli qendror .....            | 13 |
| Mbështetja financiare nga niveli lokal (komunat) .....                                                  | 15 |
| Të dhënat e anketës së GAP për përfituesit e granteve/subvencioneve nga niveli lokal .....              | 17 |
| Mbështetja financiare nga organizatat jo-qeveritare .....                                               | 19 |
| Të dhënat e anketës së GAP për përfituesit e granteve/subvencioneve nga organizatat jo-qeveritare ..... | 19 |
| Ndikimi i përfitimit të granteve/subvencioneve nga të gjitha nivelet në performancën e bizneseve .....  | 21 |
| Përfundim dhe rekomandime .....                                                                         | 22 |
| Shtojca .....                                                                                           | 23 |
| Grantet/subvencionet nga niveli qendror .....                                                           | 25 |
| Grantet/subvencionet nga niveli lokal .....                                                             | 26 |
| Grantet/subvencionet nga organizatat jo-qeveritare .....                                                | 27 |

# Lista e shkurtesave

|                 |                                                                |
|-----------------|----------------------------------------------------------------|
| → <b>ARBK</b>   | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë                 |
| → <b>FKGK</b>   | Fondi Kosovar për Garanci Kreditore                            |
| → <b>GIZ</b>    | Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar                 |
| → <b>KIESA</b>  | Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë |
| → <b>MBPZhR</b> | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural         |
| → <b>MINT</b>   | Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë             |
| → <b>MZHR</b>   | Ministria e Zhvillimit Rajonal                                 |
| → <b>NMVM</b>   | Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme                        |
| → <b>PZHRB</b>  | Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar                     |
| → <b>UNDP</b>   | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim                   |
| → <b>USAID</b>  | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar     |
| → <b>W4W</b>    | Women for Women Kosova                                         |

# Përmbledhje ekzekutive

Ndërmarrjet në pronësi të grave dhe pakicave etnike luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Megjithatë, këto biznese vazhdojnë të përballen me pengesa strukturore në qasje në financa, pronësi dhe në pjesëmarrje të barabartë në skemat e mbështetjeve financiare. Sipas një ankete me 757 biznese të realizuar nga Instituti GAP, vetëm 20% e bizneseve në pronësi të grave dhe 23% e bizneseve në pronësi të pakicave etnike kanë përfituar nga të paktën një formë mbështetjeje institucionale qendrore, lokale apo përmes organizatave joqeveritare gjatë gjithë veprimtarisë së tyre.

Të dhënat tregojnë pabarazi të vazhdueshme gjinore dhe etnike në programet mbështetëse të institucioneve publike. Sipas anketës së GAP, vetëm 7% e bizneseve në pronësi të grave dhe 8% në pronësi të pakicave etnike kanë përfituar ndonjë lloj mbështetjeje nga niveli qendror. Bazuar në të dhënat zyrtare, në skemat e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gratë përfituan mesatarisht vetëm 12% të subvencioneve gjatë viteve 2018–2024. Po ashtu, në programet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bizneset në pronësi të grave përfituan mesatarisht 16% të granteve. Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, përfshirja e bizneseve të grave nuk ka kaluar 40%, ndërsa pjesëmarrja e pakicave etnike ka mbetur e ulët dhe e paqëndrueshme ndër vite. Në nivel lokal, përfshirja është ende më e kufizuar. Sipas të dhënave të anketës, vetëm 4% e bizneseve në pronësi të grave dhe 8% e bizneseve të pakicave kanë raportuar ndonjë formë mbështetjeje nga komunat ku veprojnë. Në anën tjetër, programet e organizatave joqeveritare (OJQ) janë vlerësuar si më të qasshme dhe efektive. Rreth 10% e grave dhe 8% e përfaqësuesve të pakicave rapor-

tojnë se kanë përfituar grante dhe subvencione nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare. Mbështetja nga të gjitha nivelet është vlerësuar me ndikim të madh në qëndrueshmërinë dhe performancën e bizneseve nga mbi 95% e të anketuarve.

Bizneset përfituese të mbështetjeve institucionale në pronësi të grave janë të përqendruara kryesisht në sektorët e bujqësisë, tregtisë dhe prodhimit, ndërsa ato të pakicave etnike janë më të pranishme në sektorët e ndërtimtarisë dhe shërbimeve. Megjithatë, të dyja kategoritë dominojnë si mikro-ndërmarrje, sfidohen nga mungesa e pronësisë mbi hapësirat ku operojnë për të përfituar mbështetje, kanë kufizime në garanci kreditore dhe sfida tjera të ngjashme.

Sa i përket nivelit të edukimit, të dhënat sugjerojnë se gratë me nivel më të lartë arsimor kanë më shumë gjasa të përfitojnë nga mbështetja institucionale, pasi procesi i aplikimit shpesh kërkon përgatitje të dokumentacionit kompleks, përmbushje të kriterëve teknike dhe komunikim me institucione të ndryshme. Si rezultat, gratë me më pak arsim shpesh përjashtohen nga mundësitë ekzistuese jo për mungesë të nevojave apo të potencialit, por për shkak të pengesave burokratike që kërkojnë ndërhyrje me masa lehtësuese dhe trajnime të dedikuara.

Ky raport synon të analizojë shkallën e përfshirjes së këtyre grupeve në programet e granteve dhe subvencioneve të ofruara nga institucionet qendrore, lokale dhe organizatat joqeveritare në Kosovë. Të dhënat theksojnë nevojën për politika gjithëpërfshirëse që adresojnë mungesën e barazisë gjinore dhe etnike në programet mbështetëse.

# Hyrje


Ndërmarrjet në pronësi të grave dhe pakicave etnike në Kosovë përballen me sfida të mëdha financiare që kufizojnë konkurrueshmërinë e tyre në treg dhe potencialin për rritje. Këto biznese mbështeten kryesisht në kursimet personale si për kapitalin fillestar, ashtu edhe për operimet e përditshme.<sup>1</sup> Sipas të dhënave nga anketa gjithëpërfshirëse e realizuar nga Instituti GAP, rreth 39% e bizneseve në pronësi të grave dhe 47% e atyre në pronësi të pakicave në Kosovë janë themeluar duke përdorur kursimet personale. Megjithatë ekzistojnë programe të ndryshme të granteve dhe subvencioneve, hulumtimet tregojnë se qasja në këto burime është e kufizuar dhe ato nuk adresojnë në mënyrë të duhur nevojat specifike të këtyre ndërmarrësve. Për më tepër, tregu vendor i bizneseve dominohet nga bizneset me pronësi të burrave me 79%, krahasuar me vetëm 18% të bizneseve në pronësi të grave.<sup>2</sup> Ngjashëm, edhe në mbështetjen e ofruar nga të gjitha nivelet e institucioneve publike, dominojnë bizneset në pronësi të burrave si përfituesit kryesorë.

Sipas të dhënave të anketës me pronarë/e të 757 bizneseve, nga gjithsej 399 biznese në pronësi të grave të anketuara, vetëm 20% kanë përfituar nga të paktën një formë mbështetjeje institucionale qendrore, lokale apo përmes organizatave joqeveritare. Kjo tregon se mbi 80% e bizneseve të grave nuk kanë përfituar fare nga ndonjë formë financimi institucional. Ngjashëm, nga 358 biznese në pronësi të komuniteteve pakicë të anketuara, vetëm rreth 23% kanë përfituar nga të paktën një formë mbështetjeje in-

stitucionale qendrore, lokale ose përmes organizatave joqeveritare. Kjo tregon nivelin e ulët të përfshirjes së kësaj kategorie në skemat ekzistuese të financimit.

Niveli i përkrahjes për bizneset në pronësi të grave dhe pakicave etnike nga institucionet qendrore, lokale dhe organizatat joqeveritare

Figura 1.



Burimi: Anketa e GAP

Ky raport ka për qëllim të pasqyrojë mekanizmat ekzistues të mbështetjes për bizneset në pronësi të grave dhe bizneset në pronësi të pakicave etnike në Kosovë, si dhe të identifikojë boshllëqet në ndihmën financiare ndaj tyre. Bazuar në këto të dhëna, raporti ofron rekomandime të orientuara drejt përmirësimit të qasjes financiare, si dhe mbështetjes së rritjes së qëndrueshme së këtyre bizneseve.

<sup>1</sup> Bazuar në gjetje të anketës së GAP, 2024.

<sup>2</sup> Rreth 3% e bizneseve janë në bashkëpronësi të burrave dhe grave. Instituti GAP. Profilet e bizneseve: Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë. 2023.

# Metodologjia

Metodologjia e kërkimit të këtij raporti përfshin një shqyrtim të literaturës ekzistuese mbi grantet dhe subvencionet që janë në dispozicion për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në pronësi të grave dhe pakicave në Kosovë dhe bazohet në një anketë të realizuar nga Instituti GAP. Kjo anketë bazohet në një përzgjedhje të rastësishme të shtresuar, me 757 përgjigje të vlefshme dhe një nivel besueshmërie prej 95%. Më konkretisht, mostra e anketës përfshin gjithsej 757 biznese në pronësi të grave dhe komuniteteve pakicë, nga të cilat 399 janë biznese në pronësi të grave dhe 358 janë biznese në pronësi të komuniteteve pakicë. Nga bizneset e komuniteteve pakicë të anketuara, 79.8% janë në pronësi të burrave, 17.1% në pronësi të grave dhe 3% në pronësi të përbashkët të burrave dhe grave.<sup>3</sup>

Të dhënat e anketës janë analizuar përmes metodave statistikore, duke u fokusuar në indikatorë si: sektori primar ekonomik, madhësia e biznesit, viti i themelimit, grupmosha, niveli arsimor i pronarëve, si dhe përfitimi nga grantet/subvencionet në nivel qendror, nivel lokal dhe organizata jo-qeveritare. Për të kuptuar më mirë faktorët që ndikojnë në përfitimin e mbështetjes përmes subvencioneve nga institucionet e nivelit qendror për gratë ndërmarrëse, është zhvilluar një analizë ekonometrike mbi të dhënat e anketës me biznese në pronësi të grave (Shtojca 1). Krahas analizës së anketës, në raport janë përfshirë të dhëna administrative të mbledhura nga institucionet relevante, si Ministria e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBP-ZhR), Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), si dhe të dhëna nga komunat e rajoneve kryesore të cilat përfshijnë komunat e Prizrenit, Mitrovicës së Jugut, Gjilanit, Pejës, dhe Ferizajit. Këto të dhëna janë mbledhur përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, kombinuar me analiza të dokumentave dhe raporteve vjetore të publikuara nga institucionet përkatëse.

Në shumicën e dokumenteve të përfituesve të granteve dhe subvencioneve nga të gjitha nivelet, mungon ndarja gjinore e bizneseve përfituese.<sup>4</sup> Për këtë analizë, është përdorur Regjistri i Bizneseve i ARBK-së,<sup>5</sup> me qëllim që fillimisht të bëhet ndarja e bizneseve sipas gjinisë, e më pas të analizohen të dhënat për përfituesit, shumën e përfituar dhe vitet përkatëse.

<sup>3</sup> Periudha e kryerjes së anketës është: 16.07.2024 deri më 15.08.2024.

<sup>4</sup> Përjashtim bëjnë të dhënat nga MINT/KIESA, MZHR, Komuna e Prizrenit, dhe pjesërisht të dhënat nga MBPZhR dhe Komuna e Ferizajit të cilat ofronin të dhëna të ndara sipas gjinisë.

<sup>5</sup> Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK).



# Mbështetja financiare nga niveli qendror dhe institucionet e pavarura

Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë disa iniciativa konkrete për të mbështetur gratë ndërmarrëse përmes politikave dhe skemave financiare të dedikuara. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka ofruar mbështetjen më të madhe financiare për biznese gjatë viteve 2018–2024, me mbi 42 milionë euro në grante dhe subvencione, por përfituesit kryesorë kanë qenë burrat (mesatarisht 89% e subvencioneve dhe 68% e granteve). Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka mbështetur gratë ndërmarrëse në nivel edhe më të ulët me vetëm 16% të shumës së granteve. Nga institucionet e pavarura, Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë ka synuar të reflektojë një qasje më përfshirëse për gratë në garantimin e kredive për biznes, përmes skemës “Gratë në Biznes”, duke arritur përfaqësim mesatar prej rreth 14–15% të gjithësej portfolios. Nga të gjitha këto nivele, Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) ka pasur ndarjen më të balancuar, me rreth 32% të granteve të cilat janë shpërndarë për biznese të grave ku për dy vite të veçanta, kjo përqindje arriti 40%. Megjithatë ka përpjekje institucionale për përfshirje më të lartë të bizneseve në pronësi të grave, mbështetja financiare vazhdon të dominohet nga bizneset në pronësi të burrave.

## Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK)

Skema (dritarja) e FKGK-së, “Gratë në biznes”, synon të lehtësojë qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) që janë në pronësi ose të udhëhequra nga gratë. Përmes garancive deri në 70% të shumës së kredisë, me vlerë maksimale deri në 250,000 euro dhe afat shlyerjeje deri në 10 vjet, kjo iniciativë ofron kushte të favorshme për gratë ndërmarrëse.<sup>6</sup> Përveç komponentit financiar, programi përfshin edhe asistencë teknike, si trajnime për edukim financiar, rrjetëzim dhe mentorim.<sup>7</sup>

Gjetjet tregojnë një rritje graduale të pjesëmarrjes së grave pronare apo bashkëpronare në biznese që kanë përfituar kredi të garantuara nga FKGK. Gjatë vitit 2018, nga gjithsej 1,441 kredi të garantuara, vetëm 10% ishin lëshuar për gra pronare ose bashkëpronare në biznese. Përndryshe, nga gjithsej shuma e garancisë prej 26.8 milionë eurosh, gratë pronare ose bashkëpronare kishin përfituar garanci me rreth 2.6 milionë euro apo vetëm 9.7%. Në vitin 2019, kjo përqindje u rrit në 13%, apo rreth 9.7 milionë nga gjithsej 75.2 milionë euro, duke reflektuar ndikim të lehtë pozitiv të mekanizmit të garancisë kreditorë në mbështetjen e grave ndërmarrëse. Kjo rritje vazhdoi edhe gjatë vitit 2020, kur pjesëmarrja e grave ndërmarrëse përfituese arriti në 15% apo rreth 16.5 milionë nga gjithsej 110 milionë euro.

Në vitin 2021, në kuadër të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike, FKGK implementoi një dritare të veçantë për gratë në biznes. Përmes kësaj

<sup>6</sup> Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK). Dritarja Gratë në Biznes.

<sup>7</sup> Ibid.

skeme, pjesëmarrja e grave në portofolin e përgjithshëm të garantuar nga FKKG arriti në 14%. Kjo tregon një rënie të lehtë krahasuar me vitin paraprak por prapë mbetet më e lartë se mesatarja gjatë viteve 2018-2019. Sipas të dhënave më të fundit të vitit 2024, përmes dritares së dedikuar “Gratë në Biznes” kanë përfituar 71 ndërmarrje të udhëhequra nga gratë me gjithsej 1.9 milion euro të vlerës së garancive të ofruara.<sup>8</sup> Këto të dhëna për periudhën 2018–2024 tregojnë një përpjekje graduale për të përmirësuar qasjen në financa për gratë ndërmarrëse, megjithatë pjesëmarrja e grave në përfitimin e kredive të garantuara mbetet e ulët.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR)

Në kuadër të politikave për zhvillimin rural, MBPZhR ka ofruar grante dhe subvencione për gratë fermere, duke përfshirë edhe pikë shtesë në vlerësimin e aplikimeve për projekte bujqësore.<sup>9</sup> Sipas të dhënave, rreth 6.5% e bizne-

seve në pronësi të grave dhe 3.8% e bizneseve në bashkëpronësi të grave operojnë në sektorin e bujqësisë.<sup>10</sup> Mbështetja nga MBPZhR synon të inkurajojë pjesëmarrjen e grave në sektorin bujqësor dhe të rrisë përfshirjen e tyre në zhvillimin ekonomik rural.

Megjithatë, përqindja e përfitimit të grave nga subvencionet ka qenë vazhdimisht shumë më e ulët se ajo e burrave. Në vitin 2018, vetëm 7% e gjithsej vlerës së subvencioneve shkoi për bizneset në pronësi të grave, ndërsa 93% për burrat. Kjo përqindje ka shënuar rritje graduale në vitet në vijim: në vitin 2019 arriti 10%, më pas 12% në 2020 dhe 2021, për të arritur 13% në vitin 2022. Në dy vitet e fundit, përqindja ra në 12%. Në çdo vit të analizuar, burrat kanë përfituar pjesën më të madhe të subvencioneve, duke marrë mesatarisht rreth 88% të shumës totale, ndërsa gratë vetëm 12%. Edhe pse është shënuar një rritje e lehtë në përqindjen e mbështetjes për gratë ndër vite, hendeuku gjinor në këtë mbështetje mbetet i theksuar.

Tabela 1. Subvencionet e ndara për biznese nga MBPZhR sipas gjinisë, 2018-2024.

| Subvencione | Numri i bizneseve përfituese |                               | Vlera mesatare e përfitimit (në euro) |                               | Vlera gjithsej (në euro)    |                               | Pjesëmarrja si % e gjithsej vlerës |                               |
|-------------|------------------------------|-------------------------------|---------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------|-------------------------------|------------------------------------|-------------------------------|
|             | Biznese në pronësi të grave  | Biznese në pronësi të burrave | Biznese në pronësi të grave           | Biznese në pronësi të burrave | Biznese në pronësi të grave | Biznese në pronësi të burrave | Biznese në pronësi të grave        | Biznese në pronësi të burrave |
| 2024        | 332                          | 1461                          | 3,397                                 | 5,429                         | 1,127,645                   | 7,931,452                     | 12%                                | 88%                           |
| 2023        | 367                          | 1591                          | 3,087                                 | 5,054                         | 1,132,749                   | 8,040,324                     | 12%                                | 88%                           |
| 2022        | 284                          | 1191                          | 3,352                                 | 5,555                         | 951,901                     | 6,616,408                     | 13%                                | 87%                           |
| 2021        | 251                          | 970                           | 2,907                                 | 4,876                         | 729,574                     | 4,729,603                     | 13%                                | 87%                           |
| 2020        | 268                          | 997                           | 2,479                                 | 5,466                         | 664,481                     | 5,449,160                     | 11%                                | 89%                           |
| 2019        | 212                          | 996                           | 2,298                                 | 4,422                         | 487,227                     | 4,403,832                     | 10%                                | 90%                           |
| 2018        | 149                          | 1027                          | 1,726                                 | 3,574                         | 257,175                     | 3,670,367                     | 7%                                 | 93%                           |
| Gjithsej    | 1,863                        | 8,233                         | 19,246                                | 34,376                        | 5,350,752                   | 40,841,146                    | 12%                                | 88%                           |

Burimi: MBPZhR; Llogaritje të GAP

8 Sipas të dhënave të anketës së GAP, vetëm 0.5% e bizneseve të anketuara në pronësi të grave dhe 0.1% kanë qenë përfituese të garantimit të kredisë nga FKKG.

9 Peni, B. Nën qiellin që ndryshon, graët bartin mbi supe ndryshimet klimatike në bujqësi. 2025

10 Instituti GAP. Profilet e bizneseve; Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë. f.11.,2023.

Bazuar në të dhëna, niveli i përfitimit të granteve nga ndërmarrëset gra është ndjeshëm më i lartë në krahasim me përfitimin e subvencioneve. Në vitin 2018, gratë përfituan 37% të shumës së përgjithshme të granteve. Kjo përqindje u rrit në 39% në vitin 2019. Në vitin 2022, ndonëse me një rënie të lehtë, përqindja mbeti relativisht e lartë në 32%, ndërsa në vitin 2023 ra në 22%.<sup>11</sup>

Megjithatë, kërkesat për dokumente të shumta dhe veçanërisht kërkesa për pronësi të tokës apo objekteve përjashtojnë shumë gra fermere, pasi pjesëmarrja e grave në pronësi të pronave të pal-

uajtshme në Kosovë është e ulët, përfshirë dhe tokat bujqësore. Gjetjet tregojnë se gratë në Kosovë përbënin rreth 20% të pronave në vitin 2024.<sup>12</sup> Mungesa e informacionit në lidhje me thirrjet për mbështetje po ashtu ndikon në përfitim në nivel më të ulët të grave ndërmarrëse.<sup>13</sup> Dokumentacioni i ngarkuar, kombinuar me shpenzimet e transportit për dorëzim dhe aplikim, si dhe mungesa e besimit në kriteret përzgjedhëse janë mjaft sfiduese.<sup>14</sup> Pavarësisht përpjekjeve për ta rritur përfshirjen e grave në sektorin e bujqësisë, pengesat strukturore mbeten pengesë kryesore për qasje të barabartë në mbështetje financiare.

Tabela 2. Grantet e ndara për biznese nga MBPZhR sipas gjinisë, 2018-2023.

| Grante   | Numri i bizneseve përfituese |                               | Vlera mesatare e përfitimit (në euro) |                               | Vlera gjithsej (në euro)    |                               | Pjesëmarrja si % e gjithsej vlerës |                               |
|----------|------------------------------|-------------------------------|---------------------------------------|-------------------------------|-----------------------------|-------------------------------|------------------------------------|-------------------------------|
|          | Biznese në pronësi të grave  | Biznese në pronësi të burrave | Biznese në pronësi të grave           | Biznese në pronësi të burrave | Biznese në pronësi të grave | Biznese në pronësi të burrave | Biznese në pronësi të grave        | Biznese në pronësi të burrave |
| 2023     | 108                          | 328                           | 39,699                                | 45,683                        | 4,287,511                   | 14,984,166                    | 22%                                | 78%                           |
| 2022     | 161                          | 325                           | 48,672                                | 50,661                        | 7,836,159                   | 16,464,967                    | 32%                                | 68%                           |
| 2019     | 213                          | 275                           | 30,685                                | 37,177                        | 6,535,979                   | 10,223,655                    | 39%                                | 61%                           |
| 2018     | 263                          | 335                           | 37,681                                | 49,940                        | 9,910,202                   | 16,730,055                    | 37%                                | 63%                           |
| Gjithsej | 745                          | 1,263                         | 156,737                               | 183,461                       | 28,569,851                  | 58,402,843                    | 33%                                | 67%                           |

Burimi: MBPZhR; Llogaritje të GAP

11 Në këto të dhëna janë përfshirë vetëm bizneset, dhe përjashtuar përfitueset/it nga Grupet Lokale të Veprimit (GLV-të). Për sqarim, GLV-të janë grupe të cilat zbatojnë projekte në komunitetet ku veprojnë duke përdorur fonde nga institucionet dhe organizatat donatore, të regjistruara si organizata joqeveritare në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. [Udhëzues për aplikim](#).

12 UN Women. Profili gjinor i vendit në Kosovë. Të drejtat e pronës dhe trashëgimisë. f. 57, 2024

13 UN Women. In Kosovo, gender-responsive budgeting raises hope for rural women. 2021.

14 Instituti GAP. Sfidat dhe mundësitë e qasjes në treg për bizneset në pronësi të grave dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë. 2024. f.12.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)

MINT, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka ofruar grante për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, përfshirë edhe ato në pronësi të grave.<sup>15</sup> Këto grante kanë mbuluar qëllime të ndryshme, si blerja e makinerive, certifikimi i produkteve, mbështetja për artizanatin, inovacionin, digjitalizimin dhe fusha tjera të ngjashme.<sup>16</sup> Synimi kryesor i këtyre skemave është nxitja e prodhimit vendor dhe mbështetja e sektorëve të ndryshëm ekonomikë. Gjithashtu, MINT ka organizuar edhe panaire, siç është rasti me panairin “Gratë në Biznes”, për të promovuar produktet dhe shërbimet e bizneseve të udhëhequra nga gratë.<sup>17</sup>

Të dhënat për ndarjen e granteve për biznese në pronësi të grave dhe burrave në Kosovë gjatë viteve 2018–2024 nga MINT/KIESA shfaqin një pabarazi të vazhdueshme gjinore. Në çdo vit të analizuar, burrat kanë përfituar pjesën dërrmuese të granteve, duke marrë mesatarisht rreth 80% të shumës totale, ndërsa gratë vetëm 20%. Kjo ndarje nuk reflekton vetëm një diferencë në vlerën totale të mbështetjes, por edhe në shumën mesatare për biznes, me ndërmarrësit burra që në mënyrë të vazhdueshme përfitojnë më shumë se gratë. Megjithatë në vitin 2020 është shënuar një ndarje më e balancuar (49% për gratë dhe 51% për burrat), kjo nuk ka vijuar si trend në vitet në vazhdim.

Tabela 3. Bizneset përfituese të granteve nga MINT/KIESA, 2018-2024

| Viti     | Biznese në pronësi të grave |                       |     | Biznese në pronësi të burrave |                       |     | Gjithsej   |
|----------|-----------------------------|-----------------------|-----|-------------------------------|-----------------------|-----|------------|
|          | Vlera mesatare (euro)       | Vlera gjithsej (euro) | %   | Vlera mesatare (euro)         | Vlera gjithsej (euro) | %   |            |
| 2024     | 13,998                      | 1,063,842             | 16% | 17,228                        | 5,439,920             | 84% | 6,504,762  |
| 2023     | 26,968                      | 188,773               | 16% | 22,575                        | 957,654               | 84% | 1,146,426  |
| 2022     | 14,361                      | 114,888               | 16% | 20,896                        | 585,101               | 84% | 699,989    |
| 2021     | 2,747                       | 107,152               | 19% | 8,361                         | 459,833               | 81% | 566,985    |
| 2020     | 12,502                      | 400,079               | 49% | 20,000                        | 420,000               | 51% | 820,079    |
| 2019     | 26,667                      | 80,000                | 11% | 24,734                        | 618,350               | 88% | 698,350    |
| 2018     | 67,500                      | 135,000               | 9%  | 40,886                        | 1,349,248             | 90% | 1,484,247  |
| Gjithsej | 164,743                     | 2,089,734             | 20% | 154,680                       | 9,830,106             | 80% | 11,920,838 |

Burimi: MINT/ KIESA; Llogaritje të GAP

15 Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Përkrahja e NMVM-ve.

16 Ibid.

17 Ibid. Panairi “Gratë në Biznes”.

Bazuar në të dhënat e anketës së Institutit GAP, përfshirja e bizneseve të grave dhe të komuniteteve pakicë në skemat mbështetëse të ofruara nga KIESA rezulton të jetë e ulët. Në nivel vendor, asnjë nga bizneset e anketuara në pronësi të grave nuk raportoi të ketë përfituar ndihmë apo mbështetje nga KIESA.<sup>18</sup> Ndërkohë, për bizneset në pronësi të komuniteteve pakicë, përfshirja gjithashtu mbetet shumë e kufizuar, vetëm 2% e të anketuarve nga ky grup raportuan se kishin përfituar ndonjë formë përkrahjeje nga KIESA. Situata thekson praninë e sfidave strukture që kufizojnë qasje të barabartë të grave në mbështetje nga KIESA.<sup>19</sup>

### Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZhR)

Ky institucion përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB), ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla në të gjitha rajonet e vendit.<sup>20</sup> Qëllimi kryesor i PZHRB-së është të zvogëlojë pabarazitë rajonale dhe të promovojë zhvillimin ekonomik të qendrueshëm në të gjitha pjesët e Kosovës. Programi synon të fuqizojë ndërmarrjet lokale, duke krijuar mundësi për punësim dhe rritje ekonomike në komunitetet e ndryshme.<sup>21</sup>

Në projektet e financuara nga ky program nuk ka shpërndarje të barabartë gjinore. Gjatë periudhës 2018–2024, burrat kanë përfituar në mënyrë të vazhdueshme një përqindje më të madhe të projekteve, duke arritur deri në 78% në vitin 2020, ndërsa përfshirja e grave ka lëvizur nga 22% deri në 40%. Megjithatë në vitet 2022 dhe 2024 përqindja e grave është rritur në 40%, kjo mbetet ende larg barazisë gjinore.

**Tabela 4.** Bizneset përfituese të granteve nga MZhR sipas gjinisë, 2018-2024

| Viti                | Vlera e financimit (euro) | Numri i projekteve | Burra | %   | Gra | %   |
|---------------------|---------------------------|--------------------|-------|-----|-----|-----|
| 2024                | 2,415,779                 | 189                | 114   | 60% | 75  | 40% |
| 2023                | 1,563,003                 | 131                | 84    | 64% | 47  | 36% |
| 2022                | 3,030,934                 | 332                | 198   | 60% | 134 | 40% |
| 2021                | 1,376,279                 | 164                | 119   | 73% | 45  | 27% |
| 2020 <sup>15a</sup> | 3,881,500                 | 321                | 264   | 82% | 57  | 18% |
| 2019                | 2,387,769                 | 201                | 146   | 73% | 55  | 27% |
| 2018                | 1,346,806                 | 145                | 93    | 64% | 52  | 36% |
| Gjithsej            | 16,002,070                | 1,483              | 1,018 | 68% | 465 | 32% |

Burimi: MZhR; Llogaritje të GAP

<sup>15a</sup> Në vitin 2020, vlera e financimit përfaqëson kombinimin e fondeve nga PZHRB dhe Masa 8. Nga gjithsej 3,881,500 euro, 1,896,514 euro (ose 49%) janë financuar nga programi, ndërsa 1,984,986 euro (ose 51%) nga Masa 8.

<sup>18</sup> Bazuar në të dhëna të anketës së GAP.

<sup>19</sup> Ibid.

<sup>20</sup> Ministria e Zhvillimit Rajonal.

<sup>21</sup> Ibid.

Po ashtu, nga të gjitha bizneset përfituese të granteve nga MZHR, dominon komuniteti shumicë shqiptar, me mbi 80%, ndërsa komunitetet tjera si turk, boshnjak, e të tjerë përfitojnë kryesisht në nivel të ulët.

**Tabela 5.** Bizneset përfituese të granteve nga MZHR sipas përkatësisë etnike, 2018-2024

| Viti               | Numri i projekteve | Shqiptar | Gjithsej shqiptaret (%) | Turk | Boshnjak | Goran | Serb | Komunitetet tjera pakicë | Gjithsej pakicat etnike (%) |
|--------------------|--------------------|----------|-------------------------|------|----------|-------|------|--------------------------|-----------------------------|
| 2024               | 189                | 163      | 86%                     | 21   | 2        | 0     | 3    | 0                        | 14%                         |
| 2023               | 131                | 119      | 91%                     | 7    | 2        | 0     | 2    | 1                        | 9%                          |
| 2022               | 332                | 287      | 86%                     | 26   | 9        | 0     | 9    | 1                        | 14%                         |
| 2021               | 164                | 151      | 92%                     | 8    | 0        | 1     | 4    | 0                        | 8%                          |
| 2020 <sup>22</sup> | 153<br>168         | 133      | 87%                     | 10   | 0        | 0     | 8    | 2                        | 13%                         |
| 2019               | 201                | 167      | 83%                     | 1    | 13       | 1     | 13   | 6                        | 17%                         |
| 2018               | 145                | 118      | 81%                     | 2    | 9        | 1     | 10   | 5                        | 19%                         |
| Gjithsej           | 1,483              | 1,138    | 87%                     | 75   | 35       | 3     | 49   | 15                       | 13%                         |


Burimi: MZHR; Llogaritje të GAP

### Të dhënat e anketës së GAP për përfituesit e granteve/subvencioneve nga niveli qendror

Sipas anketës së realizuar nga Instituti GAP, të dhënat tregojnë nivel të ulët përfitimi të granteve dhe subvencioneve në nivel qendror për bizneset në pronësi të grave dhe ato të pakicave etnike. Vetëm 7% e bizneseve të udhëhequra nga gratë dhe 8% nga ato të pakicave etnike raportojnë të kenë përfituar nga këto forma mbështetjeje.

Niveli i përfitimit të granteve/ subvencioneve nga niveli qendror për bizneset në pronësi të grave

Figura 2.




Burimi: Anketa GAP

22 Në vitin 2020, numri i projekteve përfaqëson përfituesit nga PZHRB dhe nga Masa 8. Nga gjithsej 321 përfitues, 153 ose 48% janë ndarë në kuadër të programit PZHRB, ndërsa 168 ose 52% nga Masa 8.

Niveli i përfitimit të granteve/  
subvencioneve nga niveli qendror për bizneset në  
pronësi të pakicave etnike

Figura 3.



Kanë përfituar Nuk kanë përfituar


Burimi: Anketa GAP

Te bizneset në pronësi të grave, pjesa më e madhe e pronareve i takojnë grupmoshave 30–39 vjeç (38%) dhe 40–49 vjeç (38%) (Figura 1 në Shtojca). Ndërkohë, te bizneset në pronësi të pakicave etnike, përqindja më e madhe e pronarëve është e përqendruar në grupmoshën 40–49 vjeç (81%) (Figura 2 në Shtojca).

Sipas të dhënave të anketës, nga bizneset në pronësi të grave, përfituese të granteve/subvencioneve nga niveli qendror, gjysma (50%) operojnë në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, ndjekur nga 20% në tregti me shumicë dhe pakicë, 13% në prodhim. Në anën tjetër, bizneset e pronarëve nga pakicat etnike janë të fokusuar kryesisht në tregtinë me shumicë dhe pakicë me 56%, të ndjekura nga sektori i akomodimit dhe shërbimeve ushqimore me 16%, arsimit me 12% dhe bujqësia, pylltaria dhe peshkimi me 8%. Këto të dhëna tregojnë se gratë ndërmarrëse të cilat mbështeten nga niveli qendror janë më të përqendruara në sektorët prodhues dhe bujqësor, ndërsa nga pakicat etnike orientohen më shumë drejt sektorëve të tregtisë dhe shërbimeve.

Aktivitetet primare të bizneseve në pronësi të grave  
të mbështetura nga niveli qend


Figura 4.



Bujqësi, pylltari dhe peshkim Prodhim  
Tregti me shumicë dhe pakicë  
Aktivitete akomodimi dhe shërbime ushqimi  
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike  
Aktivitete të shërbimeve tjera

Aktivitetet primare të bizneseve në pronësi të pakicave etnike të mbështetura nga niveli qendror

Figura 5.



Bujqësi, pylltari dhe peshkim  
Tregti me shumicë dhe pakicë  
Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi  
Aktivitete financiare dhe të sigurimeve  
Arsimi Aktivitete të shërbimeve tjera

Burimi: Anketa GAP

Sa i përket edukimit, shumica e bizneseve në pronësi të grave që kanë përfituar nga grantet/subvencionet nga niveli qendror kanë përfunduar shkollë të mesme profesionale (45%) dhe arsim të nivelit baçelor (28%). Edhe modeli ekonometrik, i shtjelluar në shtojca,<sup>23</sup> gjenë se niveli më i lartë i edukimit rritë gjasat e grave ndërmarrëse për të përfituar grante/subvencione. Ngjashëm vlen edhe për bizneset në pronësi të pakicave etnike të cilat kryesisht kanë të përfunduar nivel të arsimit të mesëm profesional (41%) dhe nivel baçelor (28%).

Për bizneset e udhëhequra nga gratë, shumica e bizneseve të mbështetura janë themeluar pas vitit 2010 me një përqindje të lartë në vitin 2016 (37.9%) dhe 2015 (17.2%), që tregon një rritje të ndjeshme të ndërmarrjeve të grave në këto vite (Figura 3 në Shtojca). Por, të qenit një biznes me përvojë, sipas përlogaritjeve të modelit ekonometrik, nuk rrit gjasat për të përfituar subvencion, që tregon qasjen e institucioneve për të mbështetur të gjitha grupet, përfshirë bizneset e themeluara në vitet e fundit dhe start-up-et. Nga ana tjetër, për bizneset me pronarë nga pakicat

etnike, viti dominues është 2005 me 38.5% të bizneseve të mbështetura, ndërsa shpërndarja në vitet e tjera është më e balancuar dhe e përhapur në një periudhë më të gjatë kohore, duke përfshirë edhe vitet e hershme si 2000 dhe 2010 me nga 11.5%. Kjo sugjeron se bizneset e pakicave etnike të cilat përfitojnë mbështetje institucionale kanë një histori më të hershme aktiviteti, ndërsa ato të grave janë biznese më të reja dhe kanë pasur rritje të shpejtë në vitet e fundit, veçanërisht pas vitit 2015 (Figura 4 në Shtojca).

Të dhënat mbi madhësinë e bizneseve që kanë përfituar grante dhe/ose subvencione nga niveli qendror tregojnë se shumica dërrmuese janë ndërmarrje mikro, si në rastin e grave ashtu edhe të pakicave etnike. Tek bizneset me pronarë gra, 97% janë ndërmarrje mikro dhe vetëm 3% të vogla, duke treguar një dominim të qartë të mikro ndërmarrjeve. Po ashtu, edhe tek bizneset e pakicave etnike, rreth 85% janë ndërmarrje mikro, ndërsa 15% janë ndërmarrje të vogla.

<sup>23</sup> Modeli ekonometrik është kryer duke përdorur vetëm bizneset në pronësi të grave, meqë anketa për biznese në pronësi të minoriteteve nuk kishte observime të mjaftueshme rreth përfituesve të granteve/subvencioneve, që janë të domosdoshme për modelim.



# Mbështetja financiare nga niveli lokal (komunat)

Komunat luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një ambienti të favorshëm për zhvillimin e bizneseve, duke përfshirë mbështetjen për ndërmarrjet në formë të granteve, subvencioneve, apo trajnimeve të ndryshme, në veçanti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.<sup>24</sup> Shembuj të mbështetjes për biznese përfaqësojnë komuna e Prizrenit, Ferizajit, Mitrovicës së Jugut, Pejës dhe Gjilanit, të dhënat për të cilat janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.<sup>25</sup>

Komuna e Prizrenit, gjatë periudhës 2018–2024, ka ndarë subvencione për mbështetjet të bizneseve me një rritje të ndjeshme të fondeve veçanërisht në vitet e fundit. Megjithatë, nga pjesa më e madhe e kësaj mbështetje kanë përfituar kryesisht biznese në pronësi të burrave. Në vitin 2023 u ndanë rreth 89 mijë euro, ndërsa në vitin 2024 fondi i subvencioneve u rrit në mbi 108 mijë euro. Pavarësisht kësaj rritjeje, vetëm 34% e mbështetjes në vitin 2024 (36,480 euro) u nda për biznese në pronësi të grave.

Tabela 6. Mbështetja e bizneseve përmes subvencioneve sipas vlerës dhe gjinisë, 2018-2024

| Viti i mbështetjes | Vlera totale e mbështetjes (në euro) | Vlera totale e mbështetjes për biznese burra (në euro) | %   | Vlera totale e mbështetjes për biznese gra (në euro) | %   |
|--------------------|--------------------------------------|--------------------------------------------------------|-----|------------------------------------------------------|-----|
| subvencione        |                                      |                                                        |     |                                                      |     |
| 2018               | 20,350                               | 16,400                                                 | 81% | 3,950                                                | 19% |
| 2019               | 20,000                               | 12,200                                                 | 61% | 7,800                                                | 39% |
| 2020               | 30,000                               | 18,600                                                 | 62% | 11,400                                               | 38% |
| 2021               | 30,600                               | 20,600                                                 | 67% | 10,000                                               | 33% |
| 2022               | 30,000                               | 16,550                                                 | 55% | 13,450                                               | 45% |
| 2023               | 89,249                               | 51,679                                                 | 58% | 37,570                                               | 42% |
| 2024               | 108,200                              | 71,720                                                 | 66% | 36,480                                               | 34% |
| Gjithsej           | 328,399                              | 207,749                                                | 64% | 120,650                                              | 36% |

Burimi: Komuna e Prizrenit; Llogaritje të GAP

24 CDF. Shërbimet komunale për mbështetje të bizneseve në USAID/AKT-LS Komunat Partnere në Kosovë. 2017.

25 Komuna e Prishtinës nuk ka ndonjë program të veçantë për mbështetje të bizneseve sipas përgjigjes së tyre.

*Komuna e Mitrovicës së Jugut*, në bashkëpunim me organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, ka ndarë fonde për mbështetjen e bizneseve gjatë viteve të fundit përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit. Në vitin 2024, komuna ka ofruar grante për biznese bazuar në idenë më të mirë, me vlerë prej pesë mijë euro për secilin përfitues. Nga gjithsej nëntë biznese përfituese, katër prej tyre kanë qenë në pronësi të grave.<sup>26</sup> Ndërkohë, në vitin 2022, në partneritet me Ministrinë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, janë financuar dhjetë biznese të drejtuara nga gratë, me një shumë totale prej 25 mijë euro, në kuadër të skemës për mbështetjen e grave në biznes. Gjatë viteve 2023 dhe 2024, në bashkëpunim me organizatën HELP Kosova, janë ndarë mjete për rreth 20 biznese në pronësi të grave dhe komuniteteve pakicë, me një shumë totale prej 83,675 euro. Nga kjo shumë, deri në 2,400 euro janë ndarë për secilin biznes për blerjen e pajisjeve, ndërsa 19,200 euro janë ndarë nga vetë Komuna e Mitrovicës së Jugut.

*Komuna e Ferizajit* ka mbështetur vazhdimisht ndërmarrësinë vendore përmes ndarjes së granteve dhe subvencioneve për biznese të vogla dhe bizneseve start-up. Megjithatë, përfshirja e grave në këto skema ka qenë e ndryshueshme gjatë viteve. Në vitin 2020, nga gjithsej 36 biznese përfituese të granteve komunale, 26 prej tyre (73%) ishin në pronësi të grave. Në vitin në vazhdim, kjo përfshirje pësoi një rënie të ndjeshme, pasi nga 39 përfitues të granteve, vetëm 7 ishin biznese në pronësi të grave.<sup>27</sup> Në përpjekje për të rritur mbështetjen ndaj grave ndërmarrëse, në vitet 2023 dhe 2024, Komuna e Ferizajt ka ndarë fonde të veçanta për subvencionimin e bizneseve start-up, ndërmarrjeve mikro dhe atyre në pronësi të grave. Gjatë vitit 2023, janë ndarë 40 grante me vlerë nga 2,500 euro secili, të gjitha për biznese të grave. Ndërsa në vitin 2024, nga gjithsej 49 përfitues të subven-

cioneve, 35 ishin biznese të drejtuara nga gra, me nga 2 mijë euro për grant.<sup>28</sup>

*Komuna e Pejës* në vitin 2023, në bashkëpunim me organizatën HELP, ka ndarë grante për gjithsej 24 biznese, prej tyre, 45% biznese në pronësi të grave. Sipas ndarjes etnike, vetëm 4% e përfituesve i përkasin komuniteteve pakicë. Kontributi i organizatës HELP ishte rreth 88.6 mijë euro, ndërsa Komuna e Pejës ka kontribuar me 19.2 mijë euro dhe rreth 2.5 mijë euro janë ndarë në formë donacioni të pajisjeve. Në vitin 2024, Komuna e Pejës, përmes Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ka ndarë subvencione për 34 biznese me një vlerë totale prej afro 50 mijë euro. Nga këto biznese përfituese, 47% janë në pronësi të grave, ndërsa vetëm 2% e përfituesve ishin biznese të drejtuara nga pjesëtarë të pakicave etnike.

*Komuna e Gjilanit*, në vitin 2023, për herë të parë ka lansuar thirrjen publike “Fondi për Ndërmarrësit e Rinj”, me qëllim subvencionimin e bizneseve ekzistuese dhe atyre të reja, duke përfshirë edhe bizneset në pronësi të grave dhe biznese start-up. Brenda kësaj thirrjeje janë përkrahur gjithsej 45 biznese, prej të cilave 37 (82%) ishin në pronësi të grave. Vlera mesatare e grantit për biznes ishte rreth 3 mijë euro, ndërsa totali i mjeteve të ndara për këto biznese arriti në 113,348 euro. Ngjashëm, në vitin 2024 janë mbështetur gjithsej 28 biznese, prej të cilave 23 (82%) ishin në pronësi të grave. Vlera mesatare e subvencionit ka qenë 3,800 euro për biznes, ndërsa totali i fondeve të ndara ka arritur në 107,175 euro. Në vitet e mëparshme, Komuna e Gjilanit nuk ka ndarë subvencione nga buxheti vetanak për këto kategori, por ka qenë bashkëfinancuese në projekte të zbatuara nga organizata si HELP, e cila ka udhëhequr procesin e përzgjedhjes dhe mbështetjes së bizneseve.

Bizneset përfituese të këtyre granteve kanë qenë kryesisht të fokusuar në sektorë si përgatitja e ushqimeve tradicionale, ëmbëlsirave, rrobaqepë-

<sup>26</sup> Ky program është realizuar në bashkëpunim me Caritas Kosova.

<sup>27</sup> Të dhënat janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike drejtuar komunave përkatëse.

<sup>28</sup> Ibid.


sia dhe veprimtari të ngjashme, fusha të cilat përkohet edhe me numrin më të madh të grave përfituese.<sup>29</sup> Kjo tregon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet natyrës së aktiviteteve ekonomike të mbështetura dhe pjesëmarrjes së grave në këto skema. Ky orientim reflekton nevojën për politika të mëtejshme që nxisin diversifikimin e angazhimit ekonomik të grave edhe në fusha të tjera të zhvillimit.

## Të dhënat e anketës së GAP për përfituesit e granteve/subvencioneve nga niveli lokal

Sipas të dhënave të anketës së GAP, nga të gjitha bizneset në pronësi të grave, vetëm 4% kanë përfituar ndonjëherë grante dhe/ose subvencione nga niveli lokal. Për dallim, nga bizneset në pronësi të komuniteteve pakicë, 9% e tyre raportojnë se gjatë veprimtarisë së biznesit, kanë përfituar grante dhe/ose subvencione nga komunat ku këto biznese operojnë.

Niveli i përfitimit të granteve/ subvencioneve nga niveli lokal për bizneset në pronësi të grave


Figura 6.



Burimi: Anketa GAP

Niveli i përfitimit të granteve/ subvencioneve nga niveli lokal për bizneset në pronësi të pakicave etnike

Figura 7.



Burimi: Anketa GAP

Bizneset e anketuara të cilat kanë përfituar grante dhe/ose subvencione nga niveli lokal, raportojnë se mbështetjen e kanë marrë kryesisht nga komunat si: Ferizaj (40%), Prizren (20%) dhe Obiliq (13%) në rastin e bizneseve në pronësi të grave.

Mbështetja e bizneseve në pronësi të grave sipas komunave

Figura 8.




Burimi: Anketa GAP

Ndërsa për bizneset në pronësi të pakicave etnike, përfitimi më i madh është evidentuar në Mitrovicën e Veriut (33%) dhe Shtërpçë (30%), nd-

29 Ibid.

jekur nga Leposaviqi (13%) dhe Ranilluga (10%). Komunitet tjera si Kamenica, Fushë Kosova, Podujeva, Prishtina, Gjakova, Zveçani dhe Graçanica përfaqësohen me përqindje më të ulëta.





Burimi: Anketa GAP

Te bizneset në pronësi të grave, pjesa më e madhe e pronareve përfituese të mbështetjes nga niveli lokal i takojnë grupmoshave 40-49 vjeç (28%) dhe 50-59 vjeç (43%) (Figura 5 në Shtojca). Ndërkohë, te bizneset në pronësi të pakicave etnike, përqindja më e madhe e pronarëve përfitues të granteve dhe subvencioneve është e përqendruar në grupmoshën 30-39 vjeç (30%) dhe 40-49 vjeç (52%) (Figura 6 në Shtojca).

Rreth gjysma (50%) e bizneseve përfituese në pronësi të grave operojnë në sektorin e prodhimit, ndjekur nga 25% në tregti me shumicë dhe pakicë, 13% në aktivitete të shërbimeve dhe 12% në arsim. Në anën tjetër, bizneset përfituese të granteve/subvencioneve nga pakicat etnike ofrojnë shërbim primar në fushën e teknologjisë (34%), ndjekur nga ndërtimtaria (20%), bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (13%) dhe aktivitete tjera në masë më të vogël.

Këto të dhëna të anketës së GAP tregojnë se gratë të cilat përfitojnë nga mbështetja e nivelit lokal janë më të përqendruara në sektorët e prodhimit dhe tregtisë, ndërsa pakicat etnike janë të orientuar më shumë në shërbime të teknologjisë dhe komunikimit. Sa i përket vitit të themelimit, shumica e bizneseve përfituese janë

themeluar gjatë dhjetë viteve të fundit, me 36% e bizneseve në pronësi të grave të themeluara në vitin 2016, dhe 24% të bizneseve në pronësi të pakicave etnike të themeluara në vitin 2015.



Burimi: Anketa GAP

# Mbështetja financiare nga organizatat jo-qeveritare

Gjatë viteve të fundit, një sërë organizatash ndërkombëtare kanë ofruar mbështetje të konsiderueshme për NMVM-të në Kosovë, me fokus të veçantë te gratë dhe pakicat etnike. Programi për Qëndrueshmëri Ekonomike i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), i lansuar në vitin 2024, ka ndihmuar 40 biznese në forcimin e qëndrueshmërisë së tyre dhe përmirësimin e modeleve të biznesit, ku 40% e tyre ishin në pronësi të grave.<sup>30</sup> Po ashtu, programi i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik ka mbështetur përmes granteve dhe trajnimeve sipërmarrëse gra dhe nga pakicat etnike.<sup>31</sup> Nga ky aktivitet janë ndarë gjithsej 143 grante, prej tyre 960 mijë euro janë ndarë për 116 biznese në pronësi të grave dhe 237 mijë euro për 27 biznese në pronësi të pakicave etnike.<sup>32</sup>

Ndërkohë, Caritas-i në Kosovë, përmes projektit të Fuqizimit të Ekonomive Rurale në Bujqësi (EREA),<sup>33</sup> vazhdon të promovojë zhvillimin rural të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke synuar përmirësimin e qasjes në mundësi ekonomike për gratë dhe grupet e marginalizuara në zonat rurale. Ky projekt i filluar në vitin 2023 dhe i planifikuar të zgjasë deri në fund të 2026, parasheh mbështetje të këtyre bizneseve me buxhet prej 3.6 milionë franga zvicerane.<sup>34</sup> Në anën

tjetër, W4W bashkë me GIZ përmes kampanjës ‘Bizneset në pronësi të grave’ po ashtu kanë mbështetur gratë ndërmarrëse duke ofruar grante me vlerë rreth 80 mijë euro gjithsej, për idetë më të mira, promovim të punësimit, zgjerim të biznesit dhe qëllime të ngjashme.<sup>35</sup> Organizata CARE ka mbështetur biznese të reja ‘start-up’ dhe biznese në sektorin e bujqësisë, duke ofruar grante me vlerë mesatare 10 mijë euro. Deri tash, janë mbështetur 69 biznese në pronësi të grave.<sup>36</sup> Këto iniciativa përbëjnë mjete kyçe për fuqizimin ekonomik dhe nxitjen e barazisë sociale në vend.

## Të dhënat e anketës së GAP për përfituesit e granteve/subvencioneve nga organizatat jo-qeveritare

Sipas të dhënave të anketës së realizuar nga Instituti GAP, rreth 10% e bizneseve në pronësi të grave dhe 8% e atyre në pronësi të pakicave etnike në Kosovë kanë përfituar ndihmë financiare në formë grantesh nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare. Kjo përqindje është më e lartë krahasuar me nivelin e përfitimit nga skemat e ofruara nga institucionet publike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, duke treguar efektivitet më të madh të organizatave joqeveritare në ofrimin e mbështetjes së targetuar për gratë dhe pakicat etnike.

30 United Nations Development Program (UNDP). Annual Achievement Report. 2025.

31 Community Development Fund (CDF). 140 Resilience Grants Awarded.

32 Të dhënat e sigurura nga kërkesa për qasje në të dhëna të granteve të ndara nga aktiviteti i USAID-it.

33 EREA është shkurtesë për Empowering Rural Economies in Agriculture (Fuqizimi i ekonomive rurale në bujqësi). Caritas. Projekti EREA në Kosovë.


34 Ibid.

35 GIZ. Support of female entrepreneurs in Kosovo. [Supporting women-owned businesses in Kosovo](#). 2021

36 CARE International. [CARE Supports 20 Women from Kosovo to Start Businesses in Agriculture and Food Processing](#).


"Niveli i përfitimit të granteve/ subvencioneve nga organizatat jo-qeveritare për bizneset në pronësi të grave"

Figura 12.



"Niveli i përfitimit të granteve/ subvencioneve nga organizatat jo-qeveritare për bizneset në pronësi të pakicave etnike"

Figura 13.



Burimi: Anketa GAP

Të dhënat tregojnë se bizneset në pronësi të grave janë përkrahur më së shumti nga USAID (33%), Women for Women (W4W) (12%) dhe organizata të tjera në vlerë më të vogël. Ndërsa bizneset në pronësi të pakicave etnike kanë marrë mbështetje kryesisht nga USAID (67%). Te përfitueset gra dhe ato nga komunitetet pakicë, dominon sektori i prodhimit, i ndjekur nga sek-

tori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, të cilët përfitojnë më së shumti nga ndihma financiare e shpërndarë nga organizatat joqeveritare.


Aktivitetet primare të bizneseve në **pronësi të grave** të mbështetura nga organizatat jo-qeveritare

Figura 14.



Aktivitetet primare të bizneseve në **pronësi të pakicave etnike** të mbështetura nga organizatat jo-qeveritare

Figura 15.



Burimi: Anketa GAP

Mosha dominuese e bizneseve përfituese në pronësi të grave dhe të pakicave etnike është nga 50-59 vjeç (Figura 8 dhe 9 në Shtojca). Sa i përket nivelit të edukimit, pronaret e bizneseve përfituese kanë të kryer kryesisht shkollimin e mesëm profesional, me 38% të pronareve gra, dhe 59% të pronarëve nga pakicat etnike. Rreth 33% e bizneseve përfituese në pronësi të grave janë themeluar në vitin 2016, krahasuar me bizneset përfituese në pronësi të pakicave etnike të cilat janë themeluar kryesisht më herët, rreth 26% në vitin 2007, ndjekur nga 22% në vitin 2015

(Figura 11 dhe 12 në Shtojca). Për më tepër, të gjitha bizneset përfituese janë biznese mikro, ndërsa prej pakicave etnike, 90% e bizneseve përfituese janë mikro, dhe 10% biznese të vogla.


## Ndikimi i përfitimit të granteve/subvencioneve nga të gjitha nivelet në performancën e bizneseve

Të dhënat nga anketa e Institutit GAP tregojnë se përfitimi i granteve dhe subvencioneve nga të gjitha nivelet ka pasur një ndikim të konsiderueshëm pozitiv në performancën e bizneseve si për gratë, ashtu edhe për komunitetet pakicë. Te bizneset në pronësi të grave, 63% e të anketuarave deklaruan se kjo mbështetje ka ndikuar mjaftueshëm në zhvillimin e biznesit të tyre, ndërsa 33% vlerësuan se ndikimi ka qenë shumë i madh. Vetëm një përqindje shumë e vogël (3%) raportoi ndikim të ulët, dhe asnjë nuk deklaroi mungesë të plotë ndikimi.

Nga ana tjetër, te bizneset në pronësi të pakicave etnike, 51% e pjesëmarrësve vlerësuan se mbështetja financiare ka ndikuar shumë në performancën e tyre, ndërsa 48% thanë se ndikimi ka qenë mjaftueshëm pozitiv. Ngjashëm edhe në këtë grup, vetëm 2% raportuan ndikim mesatar dhe nuk kishte deklarime për ndikim të ulët apo mungesë ndikimi. Këto rezultate sugjerojnë se mbështetja përmes granteve dhe subvencioneve luan një rol kyç në fuqizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve në pronësi të grave dhe të komuniteteve pakicë.


Ndikimi i granteve/subvencioneve në performancën e bizneseve në pronësi të grave

Figura 16.



Ndikimi i granteve/subvencioneve në performancën e bizneseve në pronësi të pakicave etnike

Figura 17.



Burimi: Anketa GAP

# Përfundim dhe rekomandime

Bazuar në analizën e detajuar të skemave të mbështetjes financiare, ky raport konstaton se përfshirja e bizneseve në pronësi të grave dhe pakicave etnike në Kosovë mbetet dukshëm e ulët. Shumica e përfituesve nga skemat publike janë biznese në pronësi të burrave dhe të përqendruara në komunitetin shumicë, duke theksuar mungesën e qasjes së barabartë dhe gjithëpërfshirëse. Përfitimi nga ndihma financiare, megjithëse i kufizuar në numër dhe vlerë, ka pasur ndikim pozitiv në zhvillimin e bizneseve të grave dhe pakicave etnike, veçanërisht në përmirësimin e performancës së tyre ekonomike. Organizatat joqeveritare janë shfaqur si mbështetës më efektivë në mbështetjen e këtyre grupeve, për shkak të fleksibilitetit në kritere dhe qasjes së orientuar drejt nevojave reale të përfituesve. Prandaj, nevojitet një rishikim i politikave aktuale, me fokus në krijimin e skemave afirmative, forcimin e transparencës dhe integrimin e dimensioneve gjinore dhe etnike në proceset e planifikimit dhe zbatimit të mbështetjes financiare. Vetëm përmes një qasjeje të tillë, mund të arrihet një zhvillim më i drejtë, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm për të gjitha grupet në shoqëri.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, Instituti GAP rekomandon:

- Zhvillimin e skemave afirmative për grante dhe subvencione të dedikuara veçanërisht për gratë dhe pakicat etnike, me qëllim të zhvillimit dhe zgjerim të bizneseve të tyre. Kjo do të mund të përfshinte krijimin e kuotave ku një përqindje e caktuar e fondeve do të rezervohet vetëm për biznese në pronësi të grave dhe të pakicave etnike.
- Reduktimit të proceseve burokratike duke thjeshtuar dokumentacionin që kërkohet gjatë aplikimit për grante dhe/ose subvencione.
- Zbutje të kriterëve për mbështetje financiare, duke lehtësuar kushtin për përvojë paraprake të veprimtarisë së biznesit dhe kushtin e shumës së qarkullimit vjetor. Monitorimi duhet të jetë sa më efektiv, në mënyrë që grantet/subvencionet të shpenzohen sipas planeve të bizneseve.
- Organizimin e fushatave për informim në komunitete, sidomos në zonat rurale, për të rritur vetëdijen e grave dhe pakicave etnike për mundësitë e granteve/subvencioneve dhe mënyrën e aplikimit.
- Rritjen e transparencës në publikimin e të dhënave zyrtare dhe përfshirjen e ndarjes gjinore dhe pakicave etnike në të dhënat zyrtare të përfituesve nga institucionet publike.
- Fuqizimin e bashkëpunimit me organizatat joqeveritare, duke institucionalizuar praktikat më të suksesshme të tyre në politikat publike.
- Zgjerimin e mbështetjes teknike, përfshirë mentorim dhe asistencë për aplikim, veçanërisht për gratë dhe grupet me më pak qasje në informacione lidhur me thirrjet rreth mbështetjeje të ofruara.
- Promovimin e edukimit financiar dhe përfshirjes së grave dhe komuniteteve të pakicave etnike duke ofruar financim të targetuar dhe programe investimi, sikurse duke siguruar bashkëpunim të ngushtë me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore.



Për të kuptuar më mirë faktorët që ndikojnë në përfitimin e mbështetjes përmes subvencioneve nga institucionet e nivelit qendror për gratë ndërmarrëse, është zhvilluar një analizë ekonometrike mbi të dhënat e anketës me biznese në pronësi të grave. Meqenëse numri i bizneseve që kanë përfituar nga mbështetja është i kufizuar në rreth 9%, sipas literaturës, përveç modeleve Probit/Logit me një numër të kufizuar prediktorësh për të shmangur mbivlerësimin dhe pasigurinë statistikore është adekuate të përdoren edhe modele të specializuara për ngjarje të rralla (sikurse firthlogit).<sup>37</sup>

Probabiliteti që ndërmarrja, i, të përfitojë subvencion përllogaritet nga funksioni:

$$\Pr(\text{Subsidy}_i = 1) = \frac{1}{1 + e^{-X_i\beta}}$$

ku  $X_i$  është një vektor i variablave shpjeguese, që përfshin nivelin e edukimit, numrin e të punësuarve, anëtarësimin në shoqatë dhe moshën e biznesit, kategori për komunat, ndërsa  $\beta$  është vektori përkatës i koeficientëve. Tek modeli firthlogit, formula e përdorur në kalkulimin e koeficientëve është ndryshe nga ajo e logit, pasi që e para aplikon penalizime për të ulur anshmërinë që rezultojnë nga mostra e vogël.

Krahasimi i rezultateve mes modelit për rastet me ngjarje të rralla firthlogit dhe logit në rastin tonë nuk tregon për dallime në shenjë dhe sig-nifikancën e variablave të pavarura, si dhe dalli-

met në magjitudën e koeficientëve nuk janë të mëdha veçmas për modelet me pak variabla të pavarura. Andaj, efekti margjinal është llogaritur bazuar në modelin logit. Po ashtu, për t'u përsh-tatur me kërkesat metodologjike, për të mos humbur fuqinë e modelimit, kemi bërë edhe grupime, sikurse grupim të komunave nëpër reg-jione.<sup>38</sup>

Rezultatet e modelit tonë tregojnë se rritja e nivelit të edukimit rezultojnë të ketë ndikim të rëndësishëm në përfitimin e subvencioneve. Për rastet kur modelimi bëhet me më pak variabla të varura, të gjitha nivelet mbi atë fillor tregojnë gjasa dukshëm më të larta për të përfituar, veçanërisht individët me diplomë bachelor.

Madhësia e biznesit ka ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv, bizneset me më shumë të punësuar kanë më shumë gjasa për të përfituar, që mund të reflektojnë kapacitet më të madh për aplikim apo kriteret të përmbushura më lehtë. Po ashtu, anëtarësia në shoqata biznesi është gjithashtu me ndikim pozitiv, që lidhet me qasjen në infor-macion. Vitet e operimit të bizneseve në treg nuk kanë rezultat domethënës statistikisht, por efekti negativ tregon se bizneset më të reja kanë më shumë gjasa të përfitojnë, ndoshta për shkak të orientimit të disa skemave në start-up-e.

<sup>37</sup> Sipas King & Zeng (2001), modelet për ngjarje të rralla (si relogit) janë të nevojshme kur numri absolut i eventeve është shumë i ulët. Allison (2012) thekson se nuk ka nevojë për modele të tilla përderisa ka të paktën 15 evente për predictor. Në këtë analizë, me 36 raste pozitive dhe jo më shumë se 3 predictorë në çdo model, përdorimi i modelit Probit standard është i mbështetur metodologjikisht.

<sup>38</sup> Kemi ndërtuar edhe versione tjera të modeleve që kontrollojnë për variabla sikur regjioni apo sektorët, por ato nuk kanë ndikuar në shenjë e variablave kyçe.


|                                 | Firthlogit (1)       | Logit (2)            | Efektet marginale të Logit (2) | Firthlogit (3)       | Logit (4)            | Efektet marginale të Logit (4) |
|---------------------------------|----------------------|----------------------|--------------------------------|----------------------|----------------------|--------------------------------|
|                                 | (subvencion)         | (subvencion)         |                                | (subvencion)         | (subvencion)         |                                |
| Shkolla fillore                 | 0<br>(.)             | 0<br>(.)             | 0<br>(.)                       | 0<br>(.)             | 0<br>(.)             | 0<br>(.)                       |
| Shkolla e mesme (gjimnaz)       | 1.353<br>(1.44)      | 1.664<br>(1.50)      | 0.0675*<br>(1.68)              | 1.253<br>(1.33)      | 1.572<br>(1.40)      | 0.0698<br>(1.63)               |
| Shkolla e mesme profesionale    | 1.472*<br>(1.69)     | 1.838*<br>(1.75)     | 0.0820***<br>(2.70)            | 1.474*<br>(1.68)     | 1.852*<br>(1.75)     | 0.0942***<br>(2.69)            |
| Diplomë universiteti (bachelor) | 1.561*<br>(1.75)     | 1.915*<br>(1.80)     | 0.0891**<br>(2.47)             | 1.124<br>(1.23)      | 1.452<br>(1.34)      | 0.0609*<br>(1.77)              |
| Diplomë master/ Doktoraturë     | 1.022<br>(0.97)      | 1.210<br>(0.97)      | 0.0383<br>(0.92)               | 0.413<br>(0.37)      | 0.557<br>(0.42)      | 0.0152<br>(0.43)               |
| Numri i punëtorëve              |                      |                      |                                | 0.0646<br>(1.28)     | 0.0680<br>(1.27)     | 0.00482<br>(1.27)              |
| Odë biznesi                     |                      |                      |                                | 1.589***<br>(2.62)   | 1.627**<br>(2.57)    | 0.115**<br>(2.54)              |
| Vitet në treg                   |                      |                      |                                | -0.0753<br>(-1.43)   | -0.0798<br>(-1.50)   | -0.00565<br>(-1.49)            |
| Constant                        | -3.646***<br>(-4.41) | -4.043***<br>(-4.01) |                                | -3.080***<br>(-3.10) | -3.476***<br>(-3.01) |                                |
| Observations                    | 388                  | 388                  |                                | 388                  | 388                  |                                |

Burimi: Llogaritje të GAP

## → Grantet/subvencionet nga niveli qendror


Bizneset në pronësi të grave, përfituese të granteve/subvencioneve të nivelit qendror, sipas moshës

Figura 1.



Bizneset në pronësi të pakicave etnike, përfituese të granteve/subvencioneve, sipas moshës


Figura 2.



Burimi: Anketa GAP


Bizneset në pronësi të grave, përfituese të granteve/subvencioneve nga niveli qendror, sipas vitit të themelimit

Figura 3.



Bizneset në pronësi të pakicave etnike, përfituese të granteve/subvencioneve nga niveli qendror, sipas vitit të themelimit

Figura 4.




Burimi: Anketa GAP

## → Grantet/subvencionet nga niveli lokal


Bizneset në pronësi të grave, përfituese të granteve/subvencioneve nga niveli lokal, sipas moshës

Figura 5.



Bizneset në pronësi të pakicave etnike, përfituese të granteve/subvencioneve nga niveli lokal, sipas moshës


Figura 6.



Burimi: Anketa GAP


Bizneset në pronësi të grave, përfituese të granteve/subvencioneve nga niveli lokal, sipas vitit të themelimit

Figura 7.



Bizneset në pronësi të pakicave etnike, përfituese të granteve/subvencioneve nga niveli lokal, sipas vitit të themelimit

Figura 8.




Burimi: Anketa GAP

## → Grantet/subvencionet nga organizatat jo-qeveritare


Bizneset në pronësi të grave, përfituese të granteve/subvencioneve nga organizatat jo-qeveritare, sipas moshës

Figura 9.



Bizneset në pronësi të pakicave etnike, përfituese të granteve/subvencioneve nga organizatat jo-qeveritare, sipas moshës


Figura 10.



Burimi: Anketa GAP


Bizneset në pronësi të grave, përfituese të granteve/subvencioneve nga organizatat jo-qeveritare, sipas vitit të themelimit

Figura 11.



Bizneset në pronësi të pakicave etnike, përfituese të granteve/subvencioneve nga organizatat jo-qeveritare, sipas vitit të themelimit

Figura 12.



Burimi: Anketa GAP

**Tabela 1.** Shuma e përfituar nga bizneset në pronesi të grave nga niveli qendror, lokal dhe organizatat jo-qeveritare

| Vlera në euro | Niveli qendror | Niveli lokal | OJQ |
|---------------|----------------|--------------|-----|
| 100           | -              | 12%          | -   |
| 150           | -              | -            | 1%  |
| 400           | -              | -            | 4%  |
| 500           | 8%             | 9%           | -   |
| 600           | 1%             | -            | -   |
| 700           | -              | 9%           | -   |
| 770           | -              | 5%           | -   |
| 780           | 4%             | -            | -   |
| 800           | 3%             | 11%          | 2%  |
| 950           | 6%             | -            | -   |
| 999           | 0              | -            | -   |
| 1000          | 9%             | 3%           | 9%  |
| 1500          | 8%             | 2%           | 10% |
| 1700          |                |              | 4%  |
| 2000          | 18%            | 10%          | 7%  |
| 2020          | -              | -            | -   |
| 2500          | -              | 8%           | 9%  |
| 2700          | -              | -            | 15% |
| 2800          | -              | 7%           | -   |
| 3000          | 5%             | 10%          | 5%  |
| 3500          | 4%             | -            | -   |
| 3600          | 2%             | -            | -   |
| 4500          | 2%             | -            | -   |
| 4700          | 4%             | -            | -   |
| 5000          | -              | -            | 5%  |
| 5800          | -              | 10%          | -   |
| 6000          | -              | -            | 6%  |
| 7000          | 2%             | -            | -   |
| 8000          | 2%             |              | 5%  |
| 9000          | -              | -            | 2%  |
| 10000         | -              | -            | 8%  |
| 12000         | 4%             | -            | -   |
| 12500         | -              | -            | 4%  |
| 15000         | 2%             | -            | -   |
| 20000         | 8%             | -            | -   |
| 28000         | 2%             | -            | -   |
| 29000         | -              | -            | 2%  |
| 30000         | 2%             | -            | -   |
| 46000         | 2%             | -            | -   |
| 120000        | -              | -            | 3%  |

Burimi: Anketa GAP

**Tabela 2.** Shuma e përfituar nga bizneset në pronësi të pakicave etnike nga niveli qendror, lokal dhe organizatat jo-qeveritare

|        | Niveli qendror | Niveli lokal | OJQ |
|--------|----------------|--------------|-----|
| 500    | 1%             | -            | -   |
| 600    | 8%             | -            | -   |
| 700    | 10%            | -            | -   |
| 1,000  | -              | -            | 9%  |
| 1,500  | -              | 2%           | -   |
| 2,000  | 41%            | -            | -   |
| 2,021  | -              | 1%           | -   |
| 2,200  | -              | -            | 1%  |
| 2,500  | -              | -            | -   |
| 3,000  | 3%             | -            | 29% |
| 3,500  | -              | -            | 3%  |
| 4,000  | 1%             | 4%           | 2%  |
| 4,500  | -              | 2%           | 1%  |
| 5,000  | 23%            | 20%          | 14% |
| 5,500  | 1%             | -            | 2%  |
| 6,000  | -              | 1%           | 5%  |
| 7,000  | -              | 9%           | 10% |
| 7,500  | 2%             | 5%           | -   |
| 8,000  | 3%             | 15%          | 4%  |
| 8,500  | -              | 4%           | -   |
| 10,000 | 2%             | 28%          | 11% |
| 12,000 | 1%             | 1%           | -   |
| 15,000 | 3%             | 9%           | -   |
| 25,000 | -              | -            | 10% |

Burimi: Anketa GAP

